



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 190/20

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 36 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/20 pas shqyrtimit të kërkesës së AK-Komuna e Gjakovës nr. 190/20, kërkesë për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE "D&T Group, sh.p.k., të iniciuar nga komuna e Gjakovës më: 03.09.2020 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET, si e pa bazuar kërkesa e Autoritetit Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE "D&T Group, sh.p.k., iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizime me aparatura mjekësorë dhe jomjeksore, me Nr. Prokurimit 632-20-1456-1-2-1, Nr. Brendshëm 632-20-017- 121.

A R S Y E T I M

Autoriteti Kontraktues / Komuna e Gjakovës, me datë 29.05.2020, ka pranuar kërkesë për diskualifikim të OE "D&T Group, sh.p.k. Si arsye për marrjen e masave në pajtim të nenit 99 të LPP-se autoriteti kontraktues në kërkesën e datës 29.05.2020, ka specifikuar:

Komuna e Gjakovës, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizime me aparatura mjekësorë dhe jomjeksore, me Nr. Prokurimit 632-20-1456-1-2-1, Nr. Brendshëm 632-20-017- 121.

Gjate procesit të vlerësimit, Komisioni ka vërejtur se dokumentet e prezantuara nga Operatori Ekonomik "D&T Grottp" sh.p.k, janë të dyshimta prandaj Autoriteti Kontraktues bazuar në nenin 72 të LPP-së, ka kërkuar nga Operatori Ekonomik "D&T Group" sh.p.k, që në afatin prej 2 ditësh të sjell shpjegime të detajuara për dokumentacionin e prezantuar, me saktësisht është kërkuar nga ai që për referencat e prezantuara të na sjell kontratën dhe transaksionin bankar për furnizimin e kryer.

Me nenin 72 të LPP-së është kërkuar që Operatori Ekonomik "D&T Group-sh.p.k të dorëzojë sqarim me shkrim për dëshmitë e nevojshme si me poshtë:

- Te sjell kontratën dhe transaksionin bankar për furnizimin e kryer për projektin:

"Furnizim me mobile dhe pajisje elektroshtepiake për nevoja të kompanisë tone", e lidhur me sh.p.k. "Teking", Pas dorëzimit të dokumenteve të kërkuara (te lartshënuara) komisioni ka konstatuar se: Operatori Ekonomik "D&T Group-sh.p.k. ka prezantuar kontratën me Operatorin Ekonomik "Teking" sh.p.k., e cila nuk ka vlerë dhe data në kontratë nuk është e njëjtë me listën e prezantuar të kontratave të realizuara, që Operatori Ekonomik e ka dorëzuar në e-prokurim.

Në kontratën e prezantuar në mes të Operatorit Ekonomik "D&T Group"sh.p.k., me Operatorin Ekonomik "Taking" sh.p.k., është e lidhur me dt.05.07.2018, kurse në listën e prezantuar të kontratave të realizuara që Operatori Ekonomik e ka dorëzuar në e-prokurim data e nënshkrimit të kontratës është 06.08.2018 dhe data e përfundimit është 20.08.2018 ndërsa reference e prezantuar është me dt.06.08.2018 .

Nisur nga sa u tha si më lartën në si Autoritet Kontraktues dyshojmë se Operatori Ekonomik "D&T Group- sh.p.k. ka prezantuar dokumente të falsifikuara , prandaj kërkojmë nga ju (Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik) që të shqyrtoni faktet e dhëna nga ana jone dhe Operatorin ekonomik "D&T Group-sh.p.k. ta fusni në listën e zezë për prezantim të dokumenteve falsifikuara.

OSHP me datën 01.06.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues që të përgatisë kronologji lidhur me kërkesën e autoriteti kontraktues (AK) KK Gjakovë të datës 29.05.2020, dhe me datën 04.06.2020, është dorëzuar kronologjia me sqarimet si më poshtë:

Sipas sqarimeve të dhëna nga ana e AK-së në kërkesën e dt. 29.05.2020, vërehet se AK ka kërkuar nga OE i lartcekur që të ofroj sqarime lidhur me dokumentet si më poshtë:

- Te sjell kontratën dhe transaksionin bankar për furnizimin e kryer për projektin:

"Furnizim me mobile dhe pajisje elektroshtepiake për nevoja të kompanisë tone", e lidhur me Operatorin Ekonomik "Teking" sh.p.k. Pas dorëzimit të dokumenteve të kërkuara (te lartshënuara) komisioni ka konstatuar se:

Operatori Ekonomik "D&T Group-sh.p.k. ka prezantuar kontratën me Operatorin Ekonomik "Teking" sh.p.k., e cila nuk ka vlerë dhe data në kontratë nuk është e njëjtë me listën e prezantuar të kontratave të realizuara, që Operatori Ekonomik e ka dorëzuar në e-prokurim.

Pas dorëzimit të dokumenteve të kërkuara (te lartshënuara) komisioni ka konstatuar se:

Operatori Ekonomik "D&T Group-sh.p.k. ka prezantuar kontratën me Operatorin Ekonomik "Teking" sh.p.k., e cila nuk ka vlerë dhe data në kontratë nuk është e njëjtë me listën e prezantuar të kontratave të realizuara, që Operatori Ekonomik e ka dorëzuar në e-prokurim, dyshon se OE "D&T Group" sh.p.k. në

aktivitetin e prokurimit “Furnizime me aparatura mjekësorë dhe jomjeksore , me Nr. Prokurimit 632-20-1456-1-2-1, Nr. Brendshëm 632-20-017- 121, ka ofertuar me dokumente të falsifikuara, respektivisht “Ne kontratën e prezantuar ne mes te Operatorit Ekonomik "D&T Group"sh.p.k., me Operatorin Ekonomik "Taking" sh.p.k., është e lidhur me dt.05.07.2018, kurse në listën e prezantuar te kontratave te realizuara që Operatori Ekonomik e ka dorëzuar ne e-prokurim data e nënshkrimit te kontratës është 06.08.2018 dhe data e përfundimit është 20.08.2018 ndërsa referenca e prezantuar është me dt.06.08.2018 ”.

Sqaroje se OSHP ndërmerr masa ndaj OE-ve, konform nenit 99 të LPP-së, në atë rast kur AK argumenton para Panelit Shqyrtues se OE në fjalë ka prezantuar dokumente të falsifikuar, apo ka bërë paraqitjen e të dhënave të rreme.

Paneli shqyrtues në seancën dëgjimore të mbajtur me datën: 03.09.2020 pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, ka shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: kërkesa e AK-së e datës: 29.05.2020, raporti kronologjik i ekspertit shqyrtues i datë: 01.06.2020. dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyesh mërisë së dhënë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi konstaton se OE “D&T Group, sh.p.k., edhe pse është njoftuar nga OSHP me kërkesën e AK-së te dt. 29.05.2020, i njëjti nuk ka kthyer asnjë përgjigje për ta kundërshtuar kërkesën ne fjalë.

Paneli shqyrtues konstaton se në pajtim me nenin 99.2 të LPP-së si dhe nenin 26 paragrafi 8 i RRUOPP, OSHP nuk ka autorizim që te merr vendim për diskualifikim te OE “D&T Group, sh.p.k., duke u bazuar ne arsyen e dhënë nga AK se AK dyshon ne falsifikim te dokumenteve sepse “ne kontratën e prezantuar ne mes te Operatorit Ekonomik "D&T Group"sh.p.k., me Operatorin Ekonomik "Taking" sh.p.k., është e lidhur me dt.05.07.2018, kurse në listën e prezantuar te kontratave te realizuara që Operatori Ekonomik e ka dorëzuar ne e-prokurim data e nënshkrimit te kontratës është 06.08.2018 dhe data e përfundimit është 20.08.2018 ndërsa reference e prezantuar është me dt. 06.08.2018 .

Paneli shqyrtues konstaton se AK nuk ka dhënë asnjë prove qe tregon se OE ne fjale ka dorëzuar kontrate me data te ndryshme nga ofertomi edhe sqarimi, por AK thotë se data e kontratës se prezantuar ne mes te Operatorit Ekonomik "D&T Group"sh.p.k., me Operatorin Ekonomik "Taking" sh.p.k., nuk është e njëjte me datën qe OE ka prezantuar ne listën e kontratave, andaj paneli konstaton se ne listën e prezantuar nga OE data e kontrates se cekur si me lart ka mundur te jetë ndonjë gabim teknik, te cilin AK do te duhet ta

vërtetonte dhe ta argumentoj me prova para panelit shqyrtues e jo te jetë në mëdyshje duke mos provuar dyshimin rreth OE të cilit ka kërkuar të merrej masa në pajtim me nenin 99.2 të LPP-se.

Paneli shqyrtues konstaton në bazë të nenit 99.2 të LPP-së, marrja e masave nga OSHP-ja, ndaj operatorëve ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit vjen në shprehje vetëm nëse konstatohet se operatori ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit ka prezantuar dokumente të falsifikuara, apo ka bërë paraqitjen e të dhënave të rreme ashtu siç parashihet me nenin 99.2. të LPP-së, andaj në rastin konkret autoriteti kontraktues në bazë të dispozitave ligjore dhe akteve nën ligjore për prokurim publik, ka të parapara masa tjera që lejohet të merren për rastin në fjalë ndaj operatorit ekonomik për të cilin ka parashtruar kërkesë në OSHP për marrjen e masave në pajtim me nenin 99.2 të LPP-së.

Sepse Paneli shqyrtues është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuara nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, nuk ka arritur të ofroj ndonjë dëshmi apo prove për paraqitje të dokumenteve të rreme apo të falsifikuara nga ana e OE D&T Group, sh.p.k. iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KK Gjakovë.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur në nenin 99.2 të LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Gjakovës

1x1 OE D&T Group, sh.p.k.

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së